

PRANIMET NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE MASTER PROFESIONAL NË RESTAURIM MONUMENTESH KULTURE_KANDIDATËT PËR PROGRAM TË DYTË STUDIMI

Kandidati që aplikon për program të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve duhet të paraqesin pranë sekretarisë mësimore dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Diplomën dhe listën e notave/suplementin e diplomës, ose kopje të njehsuar me origjinalin të ciklit të dytë të studimeve. Diploma e ciklit të dytë e fituar jashtë vendit shoqërohet me aktin e njohjes dhe njehsimit të lëshuar nga QSHA ose kopje të tij të njehsuar me origjinalin brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim
- b) Diplomën dhe listën e notave/suplementin e diplomës ose kopje të njehsuar me origjinalin të ciklit të parë të studimeve. Diploma e ciklit të parë e fituar jashtë vendit shoqërohet me aktin e njohjes dhe njehsimit të lëshuar nga QSHA ose kopje të tij të njehsuar me origjinalin:
- c) Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose kopje të tyre të njësuar me origjinalin. E konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876. Datë 3.11.2010. Të Këshillit të Ministrave. "Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006. Të Këshillit të Ministrave. "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike" i ndryshuar" paraqesin dëftesën e pjekurisë (original ose kopje të njësuar me origjinalin, të konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP). Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP) ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave.
- d) Formularin i aplikimit, sipas formatit të shtojcës nr. 3.
- e) Kopjen e dokumentit të identifikimit
- f) Dy fotografi personale
- g) Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, lëshuar nga strukturat përgjegjëse për shtetasin e huaj i cili regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe. Kandidati që ka kombësi shqiptare dhe njohuri të gjuhës shqipe mund të paraqesë çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e kësaj gjuhe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar ose arsim të mesëm të lartë ose një program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.
- h) Deklaratën sipas shtojcës nr. 1
- i) Plani i plotë i programit të ciklit të dytë të studimeve përfshirë dhe syllabuset përkatëse, vërtetim i listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për njohjen e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse. Nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse.

Shënim:

Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij me prokurë.